martesë, për gratë: lindje. Djathi taze del më mirë prej të thatit. Gjalpi shënon risk edhe foshnjën e barkut. Sherbeti: del mall shëndet edhe din. Të thartat: hidhërim:

* * *

Sapuni shënon mall të pastër. Pesë kallëp sapun shënojnë pesë kohët e faljes. Llaçi: drejtim në bësim.

Kur sheh petka flamurë, sende të leshta ëndra ç' tregon?

Kush sheh dorashkë në dorë: fati i jep dorë rojë mirë. Leshi: udhëtim. Robë e mëndafshtë: dashuri. Po ta shohish mbi një mejit: është xhennet shpirt. E shitura roba të vjetra: mbarësi. E marra ose e blera roba të vjetra: varfëri Jastëku: qetësi: Flamuri në dorë, del martesë. Flamurì: I bardhë: shënon grua me besë. Flamur i kuq: luftë. I verdhi sëmundje. Jeshili: udhëtim. Perde e grisur: hajir E zeza jo mirë. Perdeja: shënon të mbash fshehur të fshehtat. Xhufka: mall edhe ndërrim Taxhi: dituri, evlad edhe përparim. Gruaja po të veshë taç: kënërohet me një person të lartër. Taki-ja, qylafi shënon udhëtim edhe niqah. Qylaf i pa larë: gjynah. Po të të japë mbreti qylaf: vjen nënpunsi. Çarafi, jataku, të mbathurat: shënojnë grua, hajir. Po me ngjyrë te zezë ose të kuqe, s'dalin mirë Mintani: gëzim. Brezi: fuqi. Brez i gjatë: jetë të gjatë. Qyrku: hajir, po në verë jo mirë. Gruaja po të veshë qyrk: mer burë. Xhybeja: martesë. Sexhadeja: grua me besë.

Sarëku edhe petkat po të shihen të bardha: a të jeshilta: fuqi edhe hajir. Për ndryshe: jo aq mirë. Robë e kuqe a e verdhë: hasmëri; për gratë: jo. Shamija: shënon grua me mirveti. Çorapi: pasuni.

Mbi vehten e tij kush sheh çadëre të ngrehur: për mbretin del përparim. Për tregëtarët: udhëtim. Shilteja: grua e mirë. Hebeja edhe dengu: udhëtim i hajirit. Qeseja e të hollavet: dituri. Qeseja ose kuleta bosh: të heq poshtë. Gruaja po të veshë petka buri: hajir. Burri po të veshë petkat e gruasë: jo mirë. Qemeri: shënon grua me mirveti. Çorapi: pasuni.

(ZOTI me dijë plot e di më mirë).

Kur sheh trëndafil, lule, erëna, ngjyrëna, martesa, ëndra ç' tregon?

Në kohë kush sheh trëndafil: trashëgon si Bilbil i Prillit. Pa kohë: se heqin mirë. Trëndafil i kuq: shënon flori. I bardhi: ergjënt. Iverdhi: sëmundje. Manushaqja: hajir edhe grua të mirë. Buhuri, myshku, Amberi, karafili edhe gjith erërat e mira: dàlin gëzim, dashuri edhe lajmë të mira. Katrani edhe erësirat e ndyra: dalin të pështirà. Lulet dalin hajir: Po pa kohë: jo mirë. Lulet me lloj ngjyra: mall e përparim. Për gratë myzhde edhe gëzim. Për të helmuarit: shpëtim nga hidhrimi: Ngjyra: shënon fshehje në punim edhe hile. Ngjyra në mjekër e në mustaqe: shënon personë me dy faqe.

Martesa me një gruâ krishterkë a çifutkë: se heqin mirë. Màrtesa me një grua të sëmurë: shënon vdekjen